


Andon Tapia

KUJTIME NË VITE



Andon Tapia

KUJTIME NË VITE

Vitet kalojnë njëri pas tjetrit; si pensionist po përpiqem të tregoj disa kujtime rinore, ato që lidhen me sportin.

Filloren e kam mbaruar në Shkollën e Kuqe në Tiranë. Në ato vite, ende fëmijë 10-12 vjeç, luanim futboll në lagje, ndërsa në shkollë luanim volejball, basketboll, atletikë midis shkollave të Tiranës.

Mësimet e para i mora nga mësuesit Milto Gura, Zahari Rama, Xhevdet Doda dhe mësuesi i fizkulturës Rexhep Spahiu, ish futbollist i ekipit kombëtar. Merrnim pjesë në ndeshjet midis shkollave fillore; ndihmoja mësuesin për lajmërimin e shokëve. Aty mësova për herë të parë se si organizoheshin aktivitetet fizkulturore midis klasave dhe shkollave në qytetin e Tiranës.

Në shkollën tonë kishte shumë sportistë të mirë, paraqiteshim me uniformë të regullt dhe përfaqësoheshim në këto aktivitete me dinjitet. Luftonim për vend të parë me shkollën "Lidhja e Prizrenit". Më duket se ne fitonim më shumë herë.

Shkollën fillore e mbarova në vitin 1947, për arsye ekonomike u futa në punë.

Viti 1949 më gjeti në bankat e Teknikumit të Fizkulturës "Vojo Kushi". Unë i përkas kontigjentit të dytë të kësaj shkolle, e cila përgatiste mësues fizkulture.

I jam shumë mirënjohës pedagogëve : Zef Hila, Vangjel Gjoni, Lym Alla, M----- Jaremiqi, veçanërisht drejtorit Vasil Naqi, të cilët punonin me përkushtim dhe na përgatitën si kuadro të denjë e të aftë.

Në vitin 1952 mbarova teknikumin e fizkulturës. Nuk do ta harrojë atë gëzim të papërsëritshëm kur më lajmëruan se më kishte dalë e drejta për studime të larta në Çekosllovakia.

Në vitin 1956 mbarova studimet në I.L.P. të Pragës.

Në vitin 1956-1957 fillova punën si mësues fizkulture në shkollën e mesme «Raqi Qirinxhi» në Korçë.

Në vitin 1957 u hap Universiteti Shtetëror i Tiranës. Shtatori i atij viti më gjeti pedagog në katedrën e fizkulturës.



UNIVERSITETI SHTETEROR I TIRANES

Dy fjalë për turizmin malor dhe alpinizmin në vendin tonë

Nuk kam ndërmend të shkruaj ose të polemizojë sesi dhe kur janë përhapur dhe masivizuar turizmi dhe alpinizmi. Lëvizja turistike me këmbë u zhvillua nga mësuesit e fizkulturës që kishin mbaruar shkollën e lartë për fizkulturë jashtë shtetit. Fillimisht, lëvizja u përhap në shkollat 8-vjeçare dhe ato të mesme, si dhe në grupe të rinjsh në qendra pune.

Lëvizja turistike pati zhvillim të mbarë, ajo nisi të masivizohej dhe të drejtohej me kompetencë profesionale. Synimi i saj ishte rritja e ndjenjës së atdhedashurisë duke njohur nga afër bukuritë e natyrës së vendit tonë, si dhe zhvillimin fizik të brezit të ri.

Për të mos thënë fare, më pak i njohur ishte alpinizmi.

Turizmi malor dhe alpinizmi janë dy lëvizje binjake, por nuk mund të barazohen, secili ka veçantitë, vlerat dhe rëndësinë e vet.

Në periudhën 1945-1956 u formuan Komitetet e Fizkulturës thuajse në të gjithë vendin, që, krahas të tjerave, i dhanë përparësi zhvillimit të futbollit, basketbollit, volejollit, gjimnastikës, çiklizmit dhe boksit, sporte këto që zhvillojnë aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në ato vite, alpinizmi në vendin tonë zhvillohej në mënyrë spontane dhe në formë gare me vrap (Tiranë-Dajt) dhe në forma të tjera të ngjashme.

Kam mendimin se më parë tek ne nisi të zhvillohej alpinizmi si sport. Në lindjen dhe mbarëvajtjen e këtij sporti një kontribut të veçantë dha Minella Kapo. Megjithëse ai nuk jeton, gjej rastin të shpreh respektin e thellë për këtë njeri të respektuar.

Minella Kapo lindi më 30 prill 1922 në Vuno të Himarës, pjesëmarrës në Luftën Nacional Çlirimtare, partizan i brigadës XI.

Në vitin 1947 e caktuan sekretar e më vonë z/kryetar të Komitetit të Kulturës Fizike dhe Sporteve, pranë Këshillit të Ministrave.

Më 1951-1955 shkoi për studime të larta në Moskë, mbaroi si pedagog për shkollat e larta dhe të mesme. Si student, arriti të shkonte në Kaukaz ku përvetësoi teknikën, metodikën dhe organizimin e lëvizjes alpinistike.

1955-1957 shef sektori në Ministrinë e Arsimit për fizkulturën, baskëpunojë me Spiro Shuteriqin, Eqerem Stermasin, Behlul Hatibin, Dervish Lisin etj.

1957-1966 Shef i Katedrës së Fizkulturës pranë U.SH.T. dhe z/kryetar i K.Sportiv „Universiteti“, më vonë „Studenti“, ku kontribuoi konkretisht në drejtimin dhe masivizimin e alpinizmit në rininë studentore dhe në rrethe.

Ne vitin 1966 u diplomua doktor në mjekësi.

- Mbi baza shkencore zhvilloi kurset e parë për teknikën e alpinizmit në Theth dhe në Dajt.
- Drejtoi punën për caktimin e shkallës së vështirësisë të ngjitjeve verore dhe dimërore.

Botoi librat “Turisti i ri” dhe “Busulla Turistike”, krahas referateve dhe artikujve shkencorë dhe publicistikë.

Në vitet 1964-1990 ka qenë anëtar i Kryesisë së Federates së Alpinizmit e Çiklizmit dhe kryetar i Komisionit Teknik të Alpinizmit deri në vitin 1980.

U.SH.T-ja NË VITET 1957-1966

Në vendin tonë nuk kishte asnjë shkollë të lartë, nxënësit më të mirë, që mbaronin arsimin e mesëm, shkonin jashtë shtetit për të studiuar.

Për të plotësuar nevojat e ekonomisë dhe të jetës shoqërore, pas çlirimit të vendit, u hapën institute, si ai i filologjisë, mjekësisë, juridikut, inxhinierisë, shkencave të natyrës.

Shumë shpejt këto fakultete dhanë frytet e parë. Mbi bazën e këtyre, në vitin 1957 u krijua universiteti i parë në vendin tonë : Universiteti Shtetëror i Tiranës.

Katedra e fizkulturës

Në korrik të vitit 1957 u krijua Katedra e Fizkulturës pranë U.SH.T.

Mungonte eksperiencia. Kjo e bënte ende më të vështirë punën e pedagogëve të saj, të cilët, krahas përgatitjes së programit mësimor, duhej të punonin edhe për ngritjen dhe stërvitjen e ekipeve sportive, për drejtimin e punimeve në terrenet sportive. Fillimisht katedra përbëhej prej shefit - Minella Kapo, pedagogët Vangjel Gjoni, Enver Bushati, Andon Tapija, përgjegjësi i terreneve Sali Nallbani dhe magazinieri Fehmi Resuli.

Kuadri mësimor dhe tranjerë ekipesh u plotësua në fund të dhjetorit (gjithsej 24 vetë).

Vitet e parë personeli i katedrës përballoi një punë të madhe dhe të lodhshme, pasi paradite bënim mësim dhe pasdite stërvitje me ekipet sportive të klubit.



Studentët duhet të plotësonin programin mësimor të edukimit fizik, të realizonin normat e caktuara dhe, detyrimisht, vitin e parë dhe të dytë të bënin nga një ekskursion në malin e Dajtit (një veror dhe një dimëror).

Minella ishte njeri i palodhshëm, çdo ditë punonim nga 12-14 orë. Hobi i tij ishte loja e shahut. Një natë ora vajti 23:00. U ngrita dhe i thashë :

-Minella, i thira në emër, se ai për mua në kohën e lirë ishte shok, çou se shkoj vonë! Atë natë kisha fituar unë, por Minella m' u pergjigj :

Jo, jo, ulu të bëjmë dhe dy lojë.

Oh-u, iu pergjigja (e respektoja si shef dhe ai më donte dhe më respektonte se çdo punë që më ngarkonte e bëja).

Ulu, ulu, me tha. Nuk e kam te loja, po mendoj tjetër gjë.

U ula dhe e pyeta : si është puna?

Kam dy gjëra : e para, dua t' i bëj një kërkesë Rektoratit, për të ndërtuar terrene të tjerë sportivë te konviktet në rrugën e Elbasanit.

Po, mirë i thashë, pak punë kemi ne këtu të pambaruara?!. Çfarë do të bëjmë më parë : mësim, stërvitje me ekipet, të përgatitim plan-konspektet etj. Është një punë e madhe, nuk do ta bëjmë dot.

Këto terrene sportivë do t' i financojë dhe ndërtojë Rektorati.

Po mirë, i thashë, kur të vijë koha ja bëjmë kërkesën.

Unë dua që kërkesën ta bëj nesër se ndryshe do ta shtyjnë për më vonë marrjen në shqyrtim.

E dyta, studentët duhet t' i bindim që gjatë pushimeve dimërore dhe verore të bëjnë pushime aktive, me qëllim të përhapim alpinizmin te studentët, të cilët kur të mbarojnë universitetin do ta përhapin alpinizmin në rrethet ku do të punojnë. Jemi keq se nuk kemi fonde, vende strehimi, bazë materiale. Duhet ta bëjmë patjetër një kurs dimëror gjatë pushimeve midis simestrave.

Pse duhet pa tjetër dimëror dhe jo veror?

Filloi të më shpjegoi se një vit më parë, në korrik të vitit 1956, në alpe kishte zhvilluar një zbor alpinistik me 12 vetë dhe se zbori dimëror do të plotësonte njohuritë që ata kishin përvetësuar.

Ai e nisi kërkesën, e cila u miratua në kohën e duhur dhe mbaroi thuajse në kohën e duhur. Studentët kishin parkun e tyre sportiv.

Dëshirën për të kryer zborin alpinistik dimëror, Minella e trajtoi si domosdoshmëri për përgatitjen e instruktorëve të ardhshëm të alpinizmit. Për mbarëvajtjen e këtij aktiviteti u morën të gjitha masat e nevojshme :

1. U përgatitën programet stërvitorë për 15 ditë.
2. U siguruan instruktorët.
3. U siguruan me ndimën e ushtrisë : xhupa, këpucë, pantallona, kokore dhe doreza për 100 zboristë.

4. U siguruan çadra, çelsa alpinë, gozhdë akulli, litarë personalë dhe kolektivë, ski etj.
5. Zbori do të zhvillohej në barakat e kampit të punëtorëve në Dajt. Akomodimi dhe ushqimi u siguruan nga Bashkimet Profesionale.
6. Drejtues i zborit do të ishte Minella Kapo dhe instruktorë : Vasil Stambuli, Kozma Grillo dhe Andon Tapija të “Studentit” dhe Petraq Kule i Beratit.

Në Janar të vitit 1958 studentë, dekanë dhe padagogë nga të gjithë fakultetet e universitetit iu drejtuan malit të Dajtit.



Në këtë zbor pjesëmarrje të mirë pati dhe nga ana e femrave.



U ndamë në toga me nga një instruktor, secili u pajisë me bazën materiale të nevojshme. Në mëngjesin e ditës së parë, të gjithë u rreshtuam para kampit. Vasil Stambuli i paraqiti forcën drejtuesit të kampit, i cili u bëri të qartë pjesëmarrësve qëllimin e këtij zbori, rregulloren dhe

orarin ditor. Zboristët iu përgjigjën me zig-zag, zig-zag, alpinista jemi ne. Asnjëherë mali i Dajtit nuk kishte parë kaq shumë njerëz, nuk kishte dëgjuar brohoritjen e përbashkët të tyre.



Në fund të çdo zbori, pjesëmarrësi që kishte plotësuar programin pajisej me diplomën e kategorisë III të alpinizmit.



Në dhjetor të vitit 1958 një grup alpinistësh (kryesisht nga Universiteti Shtetëror i Tiranës) me drejtues Minella Kapon, Kozma Grillo, Vasil Stambuli, Vasil Vreto, Tefta Zguro, Petraq Kule, Andon Tapija, Luigj Shala, dhe sovjetiku Romanenko M/M. i Sportit sulmuan dhe mbërritën në majën e Jezercës. (Shih fotot 1,2,3).

I mbarë për alpinizmin tonë ishte viti 1959 :

- Në korrik, 5 alpinistë (Luigj Shala, Petraq Kule, Kozma Grillo, Koço Qafzezi dhe Thanas Vasili) shkuan në Kaukazin Perëndimor për të bërë ngjitje dhe për të fituar titullin instruktor i alpinizmit.

Po në vitin 1959 u bë një ngjitje masive nga studentë e pedagogë në malin e Tomorrit. (Shih fotot 1,2).



- Komiteti i Kulturës Fizike e Sporteve dhe Universiteti Shtetëror i Tiranës zhvilluan aktivitetin e parë ndërkombëtar me alpinistë të huaj që erdhën në vendin tonë : ekipi i alpinistëve të Republikës Demokratike të Gjermanisë me 15 vetë dhe i Çekoslovakisë me 3 alpinistë.




Aktiviteti u zhvillua ne Alpe, kampi bazë u ngrit në Theth. Alpinistët çekoslovakë këtë aktivitet e quajtën : **“Olimpiada e parë ndërkombëtare shqiptare”**.

Ekipi ynë përfaqësohej nga Minella Kapo, drejtues i aktivitetit, Vasil Stambuli, Tefta Zguro, Andon Tapija dhe Vasil Vreto të “Studentit”, Grigor Perikliu i Elbasanit dhe Vangjel Melengu i Beratit.

I deleguar nga K.K.F. e Sporteve ishte Rexhep Rama.

Alpinistët bënë ngjitje të përbashkëta, në të njëjtin litarë punuan alpinistë të kombësive të ndryshme. Alpinistët tanë e njihnin zonën, kishin përgatitje të mirë fizike, por nuk kishin nivelin

teknik të kacavjerrjeve në shkëmb të gjermanëve dhe çekosllavakëve. Në këtë veprimtari ndërkombëtare alpinizmi ynë mësoi shumë për teknikën e kacavjerrjeve shkëmbore; ishte një shkollë e vërtetë për të gjithë ne.



Në këtë aktivitet unë shoqërova ekipin çekoslllovak, i përbërë nga tre alpinistë : Milan dhe Alice Lesakova - burrë dhe grua dhe Mazaurek, të tre nga qyteti i Brnos. Pjesëtarë të Shoqatës së Alpinizmit të qytetit të Brnos me aftësi dhe eksperiencë të madhe.



Gjatë ngjitjeve e kam vlerësuar veten, sidomos nga ana teknike gjatë kacavjerrjeve në shkëmb, me qenë se isha marrë me gjimnastikë, e cila me ka ndimuar shumë. Por nga përvoja e pakët bëhen edhe gabime teknike, gabim që, për pak, mund të më kushtonte shtrenjtë.

Po ju tregoj sesi e bëra këtë gabim pa e menduar mirë. Në mbrëmje planifikuam të ngjiteshim në majën e Visencit, me lartësi 2517 m, në perëndim të Thethit. Unë do të shoqëroja grupin prej tre vetash. Nisjen e bëmë herët në mëngjes.

Koha ishte shumë e mirë, nisëm ngjitjen të ndarë dy e nga dy. Para se të arrinim në majë, koha filloi të prishej, retë po shtoheshin gjithnjë e më shumë. Kur mbërritëm në majë filluan pikat e para të shiut, që sa vinte dhe po shtohesh. Pushimi në maj që i shkurtër, nuk mund të qëndronim për të parë rreth e rrotull bukuritë natyrore.

Në majën e Visencit kisha qenë dhe herë tjetër, e njhja mirë shtegun. Iu drejtova grupit : kemi dy mundësi : të zbresim në këtë ulluk shkëmbor se na shkurton gjysmën e rrugës apo nga u ngjitëm.

Ata thanë të zbrisnim nga u ngjitëm.

Mirë, u thashë, ju vazhdoni, ndërsa unë po kaloj nëpër këtë ulluk dhe po ju pres poshtë. Fillova të zbres me shpejtësi nëpër ullukun shkëmbor dhe, pas pak, u gjenda poshtë, në fushë. Shiu

binte pa pushim dhe shtoj, u detyrova të futesha nën një shkëmb në formë ballkoni. Isha i lagur, por ftohtë nuk ishte, shiu dhe era gjëmonin pa pushim, nuk po kuptoja se çfarë po ndodhte rreth meje. Dikur, aty afër, degjova disa zëra Tondo, Tondo! (Andon, Andon) ishte zëri i alpinistëve çekë që po më kërkonin....

U shtangën kur më panë, fytyrat e tyre nisën të çelëshin.... Të gëzuar filluan të më tregonin: Pas largimit tënd në drejtim të ullukut, shkrepiti një rrufe e fortë, duke shkukur gurë të mëdhenj, që vinin në drejtimin tënd, ne menduam se

Vetëm zbritja e shpejtë më kishte shpëtuar. I gëzuar, u thashë :

- Hajde të hamë dicka.....

Lumturia e tyre më la përshtypjet më të mira për ngjitjet në alpet tona. (Shih fotot:1-2-3-4).

- Në dhjetor të vitit 1959 Universiteti organizoi ngjitje në malin e Tomorrit nga ana e Beratit, me lartësi 2416 m (Maja 11 Shkurti).

Me gjithë kohën e keqe dhe mjegull, studentët e pedagogët mbërritën në majë.
(Shih fotot 1-2.).



➤ Prill – Maj 1960 në Çekosllovakia

Në janar 1960 mora pjesë në ngjitjen në malin e Jezercës. Kjo ngjitje ishte një përgatitje e mirë për mua, për të marrë pjesë në ngjitjet me alpinistët e Brnos. Më lajmëruan se do të shkoja në Çekosllovakia për t'u kthyer vizitën. Ishte fundi i marsit, ditën e fundit sigurova vizën dhe të nesërmen u nisa me avion.

Ditën e dytë u nisa me tren drejt Brnos, ku arrita rreth orës 20:00, ku më prisnin alpinistët çekë. Diskutuam gjatë për zhvillimin e alpinizmit në Shqipëri dhe Çekosllovakia. U njoha me programin.



Programi ndahej në dy pjesë dhe do të zhvillohej në dy zona te veçanta. Java e parë program mësimor dhe stërvitor në natyrë.

Të nesërmen u nisëm me tren në drejtim të qytetit të Pobratit. Pas pak orësh udhëtuan me këmbë drejt kufirit polak, vazhduam deri sa arritëm në vendin e caktuar : „Kaci Delina“. Ngritëm kampin. Përballë nesh ngrihej mali Tatra, si vazhdim i Karpateve, me gjatësi prej 45km. Përballë kampit ngriheshin rreth 20 maja. Në të djathtë mali Kaci Vjez, mali Ganek - 2725m, Gangovan Shtebinu - 2388 m, Zapadni Shqit e Veliki Shqit etj.



Gjatë qëndrimit në këtë zonë malore u njoha me malet që na rrethonin. Në program kishim : ecjet e lira, njohja dhe vlerësimi i dëborës, ndërimit në çdo 50 m, përdorimi i kazmës etj.

Gjatë ngjitjes së parë dëborë bëhej më e ngjeshur dhe më e rezikshme. Çdo treshe sigurohej, duke përdorur teknikën e kazmës dhe të hapave. Në treshen time bënte pjesë edhe doktoresha Ema, katër herë përfaqësuese e ekipit çek. Në majën „Veliki Shqit“ arritëm më 14:30. Zbritja u bë me siguri. Qëllimi i mësimin u realizua.

Ditët e tjera mësuam si të ndërtonim guvat e strehimit, duke treguar kujdes në prerjen e blloqeve të dëborës me dimensione përkatëse.

Mendoj se, alpinistët fillestarë, të cilët ngjiten për herë të parë në lartësi të konsiderueshme, nuk duhet të ngjiten pa marrë njohuritë e para për dëborën.

Në javën e dytë programi ishte më i vështirë, merrnin pjesë alpinistë me eksperiencë. Grupi u nda në litarë dyshe dhe treshe, ku secili njihte aftësitë e tjetrit dhe kërkesat që kishte çdo alpinist.

18 prill 1960. Ishim në strehimin Ercanska Chata. Ngjitja do të bëhej në malin Zelenc Plesa (pylli i gjelbër).

Karakteristikë e këtyre maleve ishte se vargmalet lidheshin njëri me tjetrin dhe për të mbërritur në majën kryesore duhet të kaloje disa maja ose faqe me dëborë.

Në këto male realizoheshin ngjitje të alternuara nga terreni shkëmbor në atë me dëborë, të kategorive të ndryshme. Ndërmerreshin edhe ngjitje dy ose tre ditore me fjetje jashtë.



Grupi ynë, i përbërë prej tre alpinistësh, do të realizonte një ndër këto. Ajo ishte e kategorisë së dytë.




U nisëm herët në drejtim të luginës shkëmbore. Morëm drejtimin për në majë pa i vënë kthetrat, u siguruam me litar. Si arritëm në një majë, zbritëm poshtë. Përballë na doli maja Bjelanska. Kishte dy rrugë për t'u ngjitur : nga e majta ngjitje shkëmbore dhe nga e djathta ngjitje në deborë. Zgjedhëm të dytën. Pas disa orë përpjekjesh e pamë veten në majë të Kolovy Shqit....

Prapa kishim lënë 8 alpinistë. Në kamp arritëm në orën 16:00.

Kezhmarska Kapa është e kategorisë IV së vështirësisë. E sulmuam këtë majë më 19 prill. Ngjitjen e filluam nga një oxhak në veri-lindje. Dëbora ishte e ngrirë. Ishim të detyruar të përdornim kthetrat dhe të hapnim quka me kazmën alpine. Gjatë asaj pune raskapitëse dorezat na u lagën dhe ngrinë. Të ftohtit bëhej gjithnjë dhe më i padurueshëm. Sigurimi ishte maksimal. Gërmimi me kazëm në dëborën e ngrirë sa vinte e vështirësohej; ciflat e dëborës përplaseshin në fytyrë, ato që arrinin në qafë shkriheshin nga temperatura e trupit.....

Pas katër orësh arritëm në majë, ishte ora 13.00. Nga rrezet e diellit në zenith, dëbora filloi të shkrinte. Rreziku për rënien e orteqeve ishte i pranishëm. Morëm drejtimin nga e majta. Kurrizoren e mprehtë e kaluam shaluar. Më në fund zbritëm poshtë.... Grupet e tjerë vazhdonin sipas programit.




Gjatë kësaj jave realizuam 5 ngjitje : 1 e kategorisë III, 2 të kategorisë IV dhe 2 të kategorisë V.

- Në verën e vitit 1960 u nis një grup prej tre vetësh : Minella Kapo, Tefta Zguro dhe Vasil Vreto për të kryer ngjitje shkëmbore në Republikën Demokratike të Gjermanisë.

Ja çfarë shkruan Tefta Zguro dhe Vasil Vreto për ngjtjet shkëmbore në Gjermani
(????????????)

(Shih fotot) 1-3.



- Po në verën e vitit 1960 erdhi në vendin tonë një ekip alpinistësh sovjetikë, kthyen vizitën që kishin bërë alpinistët tanë atje; të shoqëruar nga Kozma Grillo kryen ngjitje në alpe. Fatkeqësisht ky ishte takimi i fundit me alpinistë të shteteve të tjerë. Për 30 vjet alpinizmin tonë e ngujuan.



Në vitin 1964 u krijua për herë të parë Federata e Alpinizmit, Çiklizmit, Turizmit dhe Skive. Krijimi i federatës i dha hov zhvillimit, organizimit dhe rritjes cilësore të alpinizmit. Kryetari i federatës ishte honorifik. Sekretari ishte profesionist. Sekretari i parë i kësaj federate ishte Muharem Sinoimeri. Pas tij, këtë detyrë deri më 1990 e kryen Andon Tapija, Eqerem Shaba dhe Agim Tabaku.

Në gusht të vitit 1964 federata planifikoi studimin e zonës më veriore – Vermoshin dhe Bjeshkët e Namuna. Aktiviteti u zhvillua në periudhën 30 korrik-17 gusht, nën drejtimin e Minella Kapos.

Grupi përbëhej nga :

1. Minella Kapo, Andon Tapija, Vasil Vreto, Genc Kurti dhe Aleksandër Bojaxhi të Universitetit.
2. Mihal Bozdo dhe Astrit Omeri të “17 Nentorit”.
3. Vangjel Melengu i „Tomorrit“.
4. Vangjel Ristani i „Flamurtarit“.
5. Taxhedin Shehu i „Korabit“.
6. Grigor Perikliu i Elbasanit.
7. Xhelil Bakiri (MË DUKET ERDHI NGA GRAMSHI, KU ISHTE MJEK ???!!!)

Për këtë aktivitet, në ditarin e tij alpinisti Mihal Bozdo shkruan :

“.....Meqënëse grupi ishte i madh, u ndamë në katër grupe :

Zona më veriore e Vermoshit do të studiohej nga grupi i udhëhequr nga Minella Kapo; zona lindore nga grupi me komandat Andon Tapija; zona qendrore nga grupi i udhëhequr nga Vasil Vreto dhe zona perëndimore nga grupi i Vangjel Melengut.

Vermoshi ngrihet në lartësinë mbi 1070 m. nga niveli i detit, është një vend shumë piktoresk. Nga malet lëshohen përrenj që bashkohen dhe krijojnë lumin e Vermoshit. Në jug të tij shtrihet Grebeni. Ky është një stadium i vërtetë natyror, i rrethuar me kodra të gjelbëruara. Është terren shumë i përshtatshëm për ski.



Foto majtas: Astrit Omeri, Xhelil Bakiri, Minella Kapo, Vangjel Melengu, Vangjel Ristani Grigor Perikliu; në mes: Genc Kurti, Vasil Vreto, Aleksandër Bojaxhi; poshtw: Mihal Bozdo, Andon Tapia, Taxhedin Shehu. Vermosh korrik 1964.

Foto djathtas: Taxhedin Shehu, Andon Tapia, Mihal Bozdo. Vermosh korrik 1964.

Pas përfundimit të etapës së parë në Vermosh, u nisëm në drejtim të Bjeshkëve të Namuna. Udhëtuam me pajisjet mbi kafshë rreth 6 orë, deri në fshatin Mrizë. Kësaj radhe moti nuk na ndihmoi. Pothuajse gjithë kohën shteguam nën një shi të imët, që na lagu deri në kockë. Natën e kaluam në stanet e çobanëve, në një mjedis të ngrohtë dhe bujar.

Të nesërmen filluam ngjitjet. Është një kompleks i tërë malesh me lartësi 2000-2600 m. Ka një mori majash, shumë prej të cilave nuk janë shkelur kurrë nga këmba e njeriut, madje shumë prej tyre nuk kanë as emra. Ka shkëmbinj me lartësi të ndryshme – nga 70 në 400 m., disa prej tyre me pjerrësi thuhet 90 gradë.

Emocionant ishte çasti kur, më 13 gusht, rreth orës 12.30, të katër grupet ndodheshin në majat më të larta dhe, megjithëse na ndanin kilometra të tërë, me përhëndetjen tonë : “Zik-zak, zik-zak, zik-zak, hej, hej, hej alpinista jemi ne!” njoftonim njëri-tjetrin për suksesin e arritur.

Sipas porosisë, ditën e katërt të gjithë grupet u bashkuam në Theth. Në analizë, që zgjati disa orë, rezultoi se programi i parashikuar u realizua me cilësi, madje dhe u tejkalua. Asnjë alpinist nuk u lëndua; çantat ndihmës së shpejtë nuk u hapën.

Itinerari :

- Tiranë – Shkodër.
- Shkodër – Koplik – Razëm.
- Razëm – Brojë,
- Brojë - Selcë – Tamarë – Leshnicë.
- Leshnicë – Vermosh, (çadrat i ngritëm tek Posta e Kufirit).
- Vermosh – Lëpushkë – Berizhdol – Bjeshkët e Namuna.
- Bjeshkët e Namuna – Theth.
- Theth – Bogë – Koplik (me këmbë).
- Koplik – Shkodër – Tiranë.

Si përfundim :

Udhëtuam 9 ditë; bëmë 6 ditë ngjitje dhe pushuam 4 ditë.

Të shprehura në orë: udhëtuam 50 orë, nga këto 14 orë me kafshë. Rruga që përkshuam ishte 200 km.

U realizuan 38 ngjitje, ndër të cilat 6 ishin të kategorisë I, 2 të kategorisë II, 8 të kategorisë III, 10 të kategorisë IV dhe 3 të kategorisë së V“.

Deri në fund të vitit 1969 Federata u dha 12 alpinistëve titullin Mjeshtër dhe Mjeshtër i Merituar. Këta ishin :

1. Minella Kapo	M/M.Sportit	“Studenti”
2. Luigj Shala	“M/Sporti”	“17 Nëntori”
3. Vasil Stambuli	M/M.Sportit	“Partizani”
4. Petraç Kule	M/M.Sportit	“Tomorri”
5. Kozma Grillo	M/Sporti	“Studenti”
6. Grigor Perikliu	M/Sportit	“Labinoti”
7. Vangjel Ristani	M/Sportit	“Flamurtari”
8. Vangjel Melengu	M/M.Sportit	“Tomorri”
9. Andon Tapija	M/Sportit	“Studenti”
10. Aleksandër Bojaxhi	M/Sportit	“Apollonia”
11. Agim Kajanaku	M/Sportit	“Labinoti”
12. Taxhedin Shehu	M/Sportit	“Korabi”



Gjatë këtyre viteve një kontribut me vlerë kanë dhënë për propagandimin e këtij sporti kameramanët Mitat Fagu, Sokrat Musha dhe Dhimitër Lalaj.

Jam munduar të jem sa më lakonik për veprimtari ku kam qenë pjesëmarrës. Shumicën e ngjitjeve alpinistike jam munduar t'i faktoj me fotografi origjinale. Mund dhe është mirë që sa më parë të shkruhet edhe historiku i këtij sporti të mrekullueshëm. Personalisht kësaj pune nuk mund t'i futem se më mungon dokumentacioni i nevojshëm. Do të ishte një ngjarje mbresëlënëse për moshën time të shoh të botuar historikun e alpinizmit tonë.



Andon Tapia dhe Mihal Bozdo në majën e Zezë Vermosh 1964

Të më falin të gjithë ata „shokë të litarit“ të cilët nuk i kam përmendur. Pranoj çdo vërejtje shoqërore.

Falenderoj Kujtim Onuzin dhe Mihal Bozdon, të cilët më mirëpritën dhe më ndihmuan në paraqitjen e këtyre kujtimeve.

Tiranë, pranverë - vjeshtë të vitit 2007

Mjeshtri i Sportit
(Andon Tapija)